

SHTOJCA A

STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“MBalkan” SH.P.K.

Datë 09.09.2023

KAPITULLI I
EMËRTIMI, FORMA, SELIA, OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA

NENI 1 – EMËRTIMI DHE FORMA E SHOQËRISË

- 1.1 Shoqëria emërtohet si “MBalkan” Shpk.
- 1.2 Shoqëria “MBalkan” Shpk themelohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe rregullohet me anë të këtij Statuti, Aktit të Themelimit dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

NENI 2 – SELIA

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën Rr. Milto Tutulani, nr.4, nr. Pasurie 51/256, 1001, Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të çelë, transferojë dhe/ose mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, degë dhe/ose zyra përfaqësimi dhe/ose njësi vendore të çdo lloji, ndërsa, Administratori i Shoqërisë mund të çelë dhe/ose transferojë dhe/ose mbyllë adresa sekondare të ushtrimit të veprimtarisë, filiale dhe/ose agjenci.


NENI 3 – OBJEKTI

- 3.1 Shoqëria ka për objekt veprimtarie import eksportin e materialeve sportive.

Neni 4 – Kohëzgjatja

- 4.1 Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 4.2 Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

KAPITULLI II
KAPITALI, KONTRIBUTET,
NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE TË SHOQËRISË



NENI 5 – KAPITALI I SHOQËRISË, KONTRIBUTET DHE KUOTAT

- 5.1. Kapitali i Shoqërisë është 100 ALL (njëqind lekë), i ndarë në 2 kuota të zotëruara nga ortakët themelues, në masën 50% (pesëdhjetë përqind) nga Sikandar Abbas, dhe 50% (pesëdhjetë përqind)) nga Sheikh Muhammad Abdullah, të kontributit në kapital.
- 5.2 Kapitali është nënshkruar dhe do të shlyhet nga ortakët themelues si më poshtë vijon:
- **Z.Sikandar Abbas**, shtetas pakistanez, lindur më 19.12.1983, në Chakwal, Pakistan, dhe 7590 Hajar Valley, Al Malqa, Danube Accomodation, 4179, Riyadh, Pakistan madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. JC1013302, dhe **50(pesëdhjetë) lekë**
 - **Z.Sheikh Muhammad Abdullah**, shtetas pakistanez, lindur më 28.03.1970, në Lahore, Pakistan dhe banues në D-9, J&P Building, Sharjah, U.A.E, Pakistan, **50(pesëdhjetë) lekë**
- 5.3 Në bazë të kontributeve të sipërcituara, Ortakët Themelues, zotërojnë kapitalin e Shoqërisë sipas raporteve të përcaktuara më poshtë:


Ortaku	Kuota	% në Kapital	Vlera
Sikandar Abbas	1 (një)	50	50 lekë
Sheikh Muhammad Abdullah	1 (një)	50	50 lekë

NENI 6 – ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË

- 6.1 Rritja e kapitalit mund të kryhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, pa kufizim, përmes kontributit në para, në natyrë apo me kredi, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi dhe Statutit të Shoqërisë.
- 6.2 Rritja e kapitalit konsiderohet e kryer në momentin kur kuotat e emetuara dhe të nënshkruara më parë janë shlyer tërësisht.
- 6.3. Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe Statutit të Shoqërisë. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e parashikuar me ligj.
- 6.4 Zvogëlimi i kapitalit mbartet prej secilit ortak proporcionalisht me kuotat që ai ka në kapitalin e Shoqërisë.

NENI 7 – TRANSFERIMI I KUOTAVE

- 7.1 E drejta e pronësisë mbi kuotat është lirisht e transferueshme tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, pasi të jetë ezauruar e drejta e parablerjes e ortakëve të shoqërisë.
- 7.2 Ndalohet krijimi i të drejtave reale mbi kuotat e Shoqërisë me qëllim garantimin e detyrimeve të një palë të tretë, me ose pa pagesë, përveçse kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme parashikohet ndryshe.




KAPITULLI III

ASAMBLEJA E ORTAKËVE DHE ADMINISTRATORËT

Neni 8 – Asambleja e Përgjithshme, të drejtat e pjesëmarrjes dhe votës, thirrja

- 8.1 Organi vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme, në të cilën marrin pjesë gjithë ortakët e Shoqërisë.
- 8.2 Secili ortak ka të drejtën të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme, të shprehë mendimin e tij dhe të votojë, në përputhje me përqindjen e zotëruar prej tij në kapitalin e Shoqërisë.
- 8.3 Secili ortak ka të drejtën të përfaqësohet nga një person tjetër, ortak dhe jo ortak, i pajisur me një prokurë të posaçme, përmes së cilës do të mund të shprehë votën e vet. Në çdo rast, prokura do të mund të lëshohet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Ortakëve dhe është e vlefshme për thirrjen e parë dhe të dytë të saj.
- 8.4 Ortaku nuk mund të japë prokurë vote për një pjesë të kuotës së zotëruar prej tij, nëse voton personalisht për një pjesë të saj.
- 8.5 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë në Shqipëri apo jashtë saj. Pranohet mundësia që mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të zhvillohet me video/telekonferencë, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen, t'u mundësohet të ndjekin bisedën, të ndërhyjnë e japin mendimet e tyre në kohë reale lidhur me trajtimin e argumenteve dhe të votojnë në të njëjtën kohë mbi pikat e rendit të ditës. Pas verifikimit të elementeve të mësipërme, të cilat duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes, mbledhja do të quhet e zhvilluar në vendin ku Kryetari i mbledhjes dhe Sekretari, njëkohësisht kanë qenë të pranishëm.
- 8.6 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret prej Administratorit/ve, në rastin kur është e nevojshme për interesat e Shoqërisë apo kur kërkohet nga ligji, sikurse edhe nga një apo më shumë ortakë të cilët përfaqësojnë të paktën 5% (pesë për qind) të kapitalit të Shoqërisë përmes një kërkesë të shkruar drejtuar Administratorit/ve. Në çdo rast, Asambleja e Përgjithshme duhet të mbledhet të paktën një herë në vit brenda muajit të gjashtë të vitit financiar, me qëllim që të diskutojë, analizojë dhe miratojë bilancin vjetor, raportin e administratorit dhe të ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar).
- 8.7 Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret përmes një letre rekomande me kthim përgjigje apo me postë elektronike dërguar në adresën e tyre të banimit apo në adresën e tyre elektronike, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara ditës së përcaktuar për zhvillimin e Asamblesë.
- 8.8 Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës dhe të tregojë datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet mbledhja e Asamblesë dhe eventualisht edhe datën, vendin dhe orën e mbledhjes së dytë, nëse e para nuk arrin të mbledhet.
- 8.9 Asambleja e Përgjithshme konsiderohet si e thirrur në mënyrë të vlefshme dhe e mbledhur edhe nëse të gjitha formalitetet që kanë të bëjnë me thirrjen e saj nuk janë respektuar, me kusht që i gjithë kapitali i Shoqërisë të jetë i pranishëm apo i përfaqësuar




- me prokurë dhe që të gjithë ortakët të pranojnë të marrin vendim pavarësisht parregullsisë së thirrjes.
- 8.10 Nëse përmbushen këto kushte, Asambleja e Përgjithshme konsiderohet si e zhvilluar në vendin ku ndodhet Kryetari i mbledhjes dhe ku gjithashtu duhet të ndodhet edhe Sekretari, në mënyrë që të aprovojnë zbardhjen dhe nënshkrimin e procesverbalit mbi librin përkatës.
- 8.11 Në thirrjen e mbledhjes së Asamblesë e Përgjithshme duhet të jenë të përcaktuar vendet, edhe jashtë selisë së Shoqërisë, apo me video/telekonferencë nën kujdesin administratorit të Shoqërisë, ku Ortakët do të mund të mblidhen.
- 8.12 Asambleja e Përgjithshme kryesohet nga një Kryetar i emëruar nga Ortakët e pranishëm apo të përfaqësuar në Asamble. Nëse prania e një noteri nuk është e kërkuar nga kuadri ligjorë në fuqi, Asambleja zgjedh një Sekretar, i cili mund edhe të mos jetë Ortak.
- 8.13 Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme ka të drejtë të plotë të verifikojë prokurat dhe vlefshmërinë e tyre, të drejtën e Ortakëve dhe përfaqësuesve të tyre për të marrë pjesë në Asamble, dhe të vendosë nëse kjo e fundit është mbledhur në mënyrë të rregullt dhe nëse kuorumi i nevojshëm për të marrë vendime është arritur. Kryetari ka edhe të drejtën të kryesojë bisedimet dhe të marrë vendime mbi rregullat dhe procedurat lidhur me votën.
- 8.14 Vendimet, procesverbalet dhe lista e pjesëmarrësve të Asamblesë duhet të përgatiten menjëherë pas Asamblesë dhe duhet të nënshkruhen nga Kryetari dhe Sekretari i Asamblesë, sikurse edhe prej noterit, kur kjo kërkohet nga kuadri ligjor në fuqi. Lista e pjesëmarrësve i bashkëlidhet procesverbalit të mbledhjes si dhe çdo dokumentacion tjetër në lidhje me vendimmarrjen e Asamblesë së Përgjithshme. Administratori/ët, është/janë përgjegjës për mbajtjen e kopjes së dokumentacionit të sipërcituar.

Neni 9 –Kompetencat e Asamblesë dhe Kuorumi

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme vendos mbi çështjet e mëposhtme:
- zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar;
 - ndryshimin e Statutit të Shoqërisë;
 - transformimin, ndarjen, bashkimin, likuidimin ose prishjen e Shoqërisë, si dhe riorganizimin e saj në çdo formë tjetër;
 - pjestimin e kuotave të Shoqërisë dhe anulimin e tyre;
 - përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe planit strategjik të zhvillimit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre nga Administratori, përfshirë raportimet financiare;
 - miratimin e buxhetit vjetor dhe planit të biznesit të Shoqërisë dhe çdo ndryshimi të tyre;
 - miratimin e pasqyrave financiare në mbyllje të çdo viti ushtrimor dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë të përgatitura nga Administratori;
 - miratimin e shpërndarjes së fitimeve vjetore;



N. Arifović



- i. emërimin dhe shkarkimin e Administratorit, si dhe përcaktimin e shpërblimeve përkatëse;
 - j. emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël dhe/ose likuiduesve dhe përcaktimin e shpërblimeve përkatëse;
 - k. miratimin e degëve dhe zyrave të përfaqësimit të Shoqërisë brenda dhe jashtë vendit;
 - l. miratimin e krijimit të shoqërive të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimeve të cilit do lloji qofshin që kanë të bëjnë me investim, financim, fitim të drejtash apo pjesëmarrjesh në projekte ekzistuese apo të reja;
 - m. blerjen dhe shitjen e pjesëmarrjeve në shoqëri të tjera, si dhe dhënien e kontributit në kapitalin e shoqërive të tjera;
 - n. miratimin e kërkesave të reja dhe rinovimin e kërkesave ekzistuese për financimin Shoqërisë apo subjekteve/palëve të treta;
 - o. vendosjen e barrëve, hipotekës, pengut apo garanci të çdo lloji tjetër mbi pasuritë e Shoqërisë;
 - p. dhënien e çdo garancie ose nënshkrimin e çdo marrëveshje të tjetër për të siguruar përmbushjen e detyrimeve financiare ose jo financiare ndaj të tretëve, për vlera më të mëdha se 100' 000 EUR;
 - q. shitjen e shoqërisë ose degëve të saj;
 - r. shitjen, blerjen apo shkëmbimin e pasurive të paluajtshme të Shoqërisë.
- 9.2 Asambleja e Ortakëve mund të marrë vendime në mënyrë të vlefshme në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
- 9.3 Në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk mblidhet me thirrjen e parë për mungesën e njërit prej Ortakëve, Asambleja e Përgjithshme do të thirret sërish brenda 7 (shtatë) ditësh me të njëjtin rend dite.

Neni 10 – Administratori/ët

- 10.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkërisht me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratori/ët do të qëndrojnë/në në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovohet automatikisht edhe për një vit tjetër.
- 10.2 Administratori/ët përfaqëson/jnë ligjërisht Shoqërinë dhe ushtron/jnë të gjitha të drejtat dhe kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr. 9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme/ aktet e emërimit të tyre. Përveç kompetencave të parashikuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare përmes këtij Statuti, Administratori ka të drejtë të hartojë, formalizojë dhe komunikojë procedurat e brendshme,

urdhrat dhe udhëzimet që duhet të dalin në zbatim të këtij Statutit dhe/ose si detyrim i legjislacionit në fuqi për fusha të caktuara nga të cilat ndikohet veprimtaria e Shoqërisë, ose që prodhojnë detyrime/ të drejta për të.

- 10.3 Administratori/ët mund të emërojë/në përfaqësues me prokurë të posaçme (“ad negotia”) kryerjen e një veprimi ose disa veprimeve, në kufijtë e tagrave që i/u janë dhënë nga ligji, statuti dhe/ose akti i emërimit.
- 10.4 Caktohet si Administrator i parë i Shoqërisë : **Z.Malik Nasir Mehmood**, shtetas Pakistani, i datëlindjes 21.12.1977, lindur Rawaldi, Pakistan, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me pasaporten me nr. BY0150224.

Neni 11 – Eksperti kontabël i autorizuar

- 11.1 Nëse kërkohet nga ligji ose një vendim i tillë merret nga Asambleja e Përgjithshme, pasqyrat financiare dhe librat kontabël të Shoqërisë do të kontrollohen/ auditohen nga një apo më shumë ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 11.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të revokohet në çdo çast në bazë të kushteve të përcaktuara nga legjislacionin në fuqi.

KAPITULLI IV

VITI USHTRIMOR, PASQYRAT FINANCIARE VJETORE DHE SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 12– Viti financiar dhe bilanci vjetor


- 12.1 Viti ushtrimor fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.
- 12.2 Viti i parë ushtrimor fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, dhe përfundon më 31 Dhjetor, të të njëjtit vit.
- 12.3 Pasqyrat financiare dhe raporti i ecurisë i hartuar prej Administratori dhe raporti që hartohet nga eksperti kontabël i emëruar (në rast se është emëruar një i tillë), miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.
- 12.4 Miratimi i dokumenteve lidhur me vitin ushtrimor duhet të kryhet brenda 3 (tre) muajve nga përfundimi i këtij vitit.

Neni 13 – Fitimet

- 13.1 Fitimet neto që rezultojnë nga pasqyrat financiare vjetore, i shpërndahen Ortakëve në përpjesëtim me pjesët takuese të tyre në kapitalin e Shoqërisë.
- 13.2 Asambleja, gjithashtu, mund të vendosë të mbajë shuma të caktuara si rezerva, apo të shtyjë shpërndarjen e fitimeve, tërësisht apo pjesërisht për vitin/et ushtrimore pasardhës.

KAPITULLI V

SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË



Neni 14 – Shpërndarja

- 14.1 Shoqëria shpërndahet në përfundim të afatit të saj parashikuar në Statut apo edhe përpara këtij afati, në rastet e parashikuar nga ligji apo me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, me shumicën e parashikuar për ndryshimin e Statutit të Shoqërisë.
- 14.2 Shoqëria nuk shpërndahet në rast paaftësie, vdekjeje apo falimentimi të ortakëve.

Neni 15 – Likuidimi

- 15.1 Në rast shpërndarjeje Shoqëria do të kalojë në procedurën e likuidimit.
- 15.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë likuidatorë, të cilët do të paraqesin raportin përfundimtar mbi gjendjen e pasivit dhe aktivitetit të Shoqërisë, mbi veprimet e likuidimit dhe kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 15.3 Në përfundim të procedurës së likuidimit, Asambleja e Përgjithshme do të marrë vendim në lidhje me bilancin financiar përfundimtar, mbi vlefshmërinë e punës së kryer prej likuidatorit dhe mbi përfundimin e procedurës së likuidimit.
- 15.4 Pas kryerjes së pagesës së kreditorëve/eve dhe tërheqjes së kredive, likuidatori/ët do të shpërndajnë të ardhurat përfundimtare të likuidimit tek ortakët, proporcionalisht me kuotat që ata respektivisht kanë në kapitalin e Shoqërisë.

KAPITULLI VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 16 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 16.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga ose në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtyre dispozitave të këtij Statuti, midis ortakëve ose midis një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen me marrëveshje mes palëve. Në rast se nuk arrihet një zgjidhje me marrëveshje, palët mund t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 17 – Dispozitat ligjore në fuqi

- 17.1 Për gjithçka që nuk parashikohet në këtë Statut, zbatohen dispozitat ligjore në fuqi.
- 17.2 Autorizohet administratori i shoqërisë që të regjistrojë Shoqërinë në Regjistrin Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Miratuar nga:


Ortakët Themelues:

Sikandar ABBAS

SIKANDAR ABBAS



Sheikh Muhammad ABDULLAH



Sheikh Muhammad Abdullah

ANNEX A

**STATUTE OF
LIMITED LIABILITY COMPANY
“MBalkan” Ltd.
DATED 09.09.2023**

**CHAPTER I
NAME, FORM, HEADQUARTERS, OBJECT AND DURATION**

ARTICLE 1 - NAME AND FORM OF THE COMPANY

- 1.1 The company is named “MBalkan” Ltd.
- 1.2 The company “MBalkan” Ltd is founded according to the Albanian legislation in force in the form of a limited liability company and is regulated by its Foundation Act, this Statute and by the laws of the Republic of Albania in force.
- 1.3 The company has its official seat and logo.

ARTICLE 2 – HEADQUARTERS

- 2.1 The headquarter office of the Company is at the address: Rr. Milto Tutulani, nr.4, nr. Pasurie 51/256, 1001, Tirana, Albania.
- 2.2 The General Assembly can make decision to open, transfer and / or close, both within Albania territory and abroad, branches and / or representative offices and / or local units of any kind, while the Administrator of the Company may decide to open and / or transfer and / or close secondary addresses of business, subsidiaries and / or agencies. The company can open offices, branches, representative offices and agencies at other addresses both in Republic of Albania and abroad.

ARTICLE 3 – THE OBJECT OF THE COMPANY

- 3.1 Object of the Company's activity is the export-import of sports materials.

ARTICLE 4 – DURATION

- 4.1 The company is established for an unlimited duration.
- 4.2 The company may be dissolved at any time by decision of the General Assembly.

**CHAPTER II
CAPITAL, CONTRIBUTIONS,
DIVISION AND TRANSFER OF COMPANY QUOTAS**



ARTICLE 5 – THE CAPITAL OF THE COMPANY, CONTRIBUTIONS AND QUOTAS

- 5.1. The capital of the Company is 100 ALL (one hundred ALL), divided into 2(two) quotas owned by the founding partners in the amount of 50% (fifty percent) by Sikandar Abbas, and 50% (fifty percent) by Sheikh Muhammad Abdullah, of the capital contribution.
- 5.2 The capital has been subscribed and will be repaid by the founding partners as follows:
- **Mr. Sikandar Abbas**, Pakistani citizen, born on 19.12.1983, in Chakwal, Pakistan, adult and with full legal capacity to act, holder of the passport no.JC1013302, **50(fifty) Abanian Lek**
 - **Mr. Sheikh Muhammad Abdullah**, Pakistani citizen, born on 28.03.1970 in Lahore, Pakistan, adult and with full legal capacity to act, holder of the passport no. DL1074744, **50(fifty) Abanian Lek**
- 5.3 Based on the above contributions, the Founding Partners own the capital of the Company as follows:

Founding Partner	Quota	% in Capital	Amount
Sikandar Abbas	1 (one)	50	50Albanian Lek
Sheikh Muhammad Abdullah	1 (one)	50	50Albanian Lek

ARTICLE 6 - INCREASING AND REDUCING THE CAPITAL OF THE COMPANY

- 6.1 The capital increase can be performed by decision of the General Assembly of Partners/ Shareholders, without restriction, through the contribution in cash, in kind or by credit, in compliance with the legal provisions in force and the Statute of the Company.
- 6.2 The capital increase will be considered fully performed at the moment when the quota/s issued and signed are fully repaid.
- 6.3. The reduction of the capital of the Company can be performed by the approval of General Assembly of Partners/ Shareholders by making decision, in accordance with the legal provisions of the Albanian Law in force and by the provisions of the Statute of the Company. In any case, the capital of the Company may not be reduced below the minimum provided by law.
- 6.4 The reduction of capital is performed by each partner in proportion to the shares he has in the capital of the Company.

ARTICLE 7 - TRANSFER OF QUOTAS

- 7.1 The ownership right over the quotas is freely transferable to third parties in accordance with the provisions of Law no. 9901, dated 14 March 2008 "On traders and companies",



amended, after the partners/ shareholders have been performed their right to pre-purchase the quota/s.

- 7.2 It is prohibited to create real rights over the shares of the Company in order to guarantee the obligations of a third party, with or without payment, unless otherwise provided by a decision of the General Assembly.

CHAPTER III

THE GENERAL ASSEMBLY OF PARTNERS AND ADMINISTRATORS

ARTICLE 8 – THE GENERAL ASSEMBLY, RIGHTS OF PARTICIPATION AND VOTING, CONVENING


- 8.1 The decision-making body of the Company is the General Assembly, in which participate all the partners of the Company.
- 8.2 Each partner has the right to participate in the General Assembly, to express his opinion and to vote, in accordance with the percentage he owns in the capital of the Company.
- 8.3 Each partner has the right to be represented by another person, partner, and non-partner, provided with a special power of attorney, through which he can express his vote. In any case, the power of attorney may be issued only for a meeting of the General Assembly of Partners and is valid for its first and second convocation.
- 8.4 The partner cannot give a power of attorney to vote for a part of the quota owned by him in case he votes personally for a part of it.
- 8.5 The General Assembly can be convened outside the headquarters of the Company in Albania or abroad. The possibility for the General Assembly meeting to take place via video / teleconference is accepted, provided that all participants can be identified, enabled to follow the conversation, intervene and give their opinions in real time regarding the handling of arguments and to vote at the same time on the agenda items. After verifying the above elements, which should be reflected in the minutes of the meeting, the meeting will be called/held in the place where the Chairman of the meeting and the Secretary were present at the same time.
- 8.6 The General Assembly may be convened by the Administrator/s when necessary for the interests of the Company or when required by law, as well as by one or more partners who represent at least 5% (five percent) of the capital of the the company, through a written request addressed to the Administrator/s. In any case, the General Assembly must meet at least once a year within the sixth month of the financial year, in order to discuss, analyze and approve the annual balance sheet, the report of the administrator and the chartered accountant (if appointed).
- 8.7 The General Assembly must be convened by registered letter with reply or by e-mail sent to their residential address or to their e-mail address, at least 7 (seven) days before the date set for the convening of the Assembly.



- 8.8 The notice must contain the agenda and indicate the date, place and time where the meeting of the Assembly will take place and eventually the date, place and time of the second meeting, if the first fails to convene.
- 8.9 The General Assembly is considered validly convened even if all the formalities related to its convening are not respected, provided that all the capital of the Company is present or represented by proxy and that all partners agree to make a decision despite the irregularity of the call.
- 8.10 If these conditions are met, the General Assembly is considered as held in the place where the Chairman of the meeting is located and where the Secretary must also be present, in order to approve the clarification and signing of the minutes on the relevant book.
- 8.11 In the convening of the meeting of the General Assembly must be determined the places, even outside the headquarters of the Company, or by video /teleconference under the care of the administrator of the Company, where the Partners will be able to meet.
- 8.12 The General Assembly is chaired by a Chairman appointed by the Partners present or represented in the Assembly. If the presence of a notary is not required by the applicable legal framework, the Assembly elects a Secretary, who may not be a Partner.
- 8.13 The President of the General Assembly has the full right to verify the power of attorneys and their validity, the right of the Partners and their representatives to participate in the Assembly, and to decide whether the latter is properly convened and whether the necessary quorum to make decisions has been validly achieved. The chairperson also has the right to chair the talks and make decisions on voting rules and procedures.
- 8.14 Decisions, minutes and the list of participants of the Assembly must be prepared immediately after the Assembly and must be signed by the President and the Secretary of the Assembly, as well as by the notary, when required by the applicable legal framework. The list of participants is attached to the minutes of the meeting as well as any other documentation related to the decision-making of the General Assembly. The administrator (s) is /are responsible for keeping a copy of the above documentation.

ARTICLE 9 - COMPETENCIES OF THE ASSEMBLY AND QUORUM

- 9.1 The General Assembly decides on the following issues:
- a. increase or reduction of share capital;
 - b. amending the Statute of the Company;
 - c. transformation, division, merger, liquidation or dissolution of the Company, as well as its reorganization in any other form;
 - d. division of the Company's shares and their cancellation;
 - e. defining the Company's commercial policies and strategic development plan and overseeing their implementation by the Administrator, including financial reporting;
 - f. approval of the annual budget and business plan of the Company and any changes thereto;



- g. approval of the financial statements at the end of each fiscal year and activity progress reports prepared by the Administrator;
 - h. approval of the distribution of annual profits;
 - i. the appointment and dismissal of the Administrator, as well as the determination of the respective remuneration;
 - j. appointment and dismissal of accounting experts and /or liquidators and determination of relevant remuneration;
 - k. approval of the branches and representative offices of the Company inside and outside the country;
 - l. approving the establishment of mutual cooperation societies and collaborations of any kind, whether related to investment, financing, acquisition of rights or participation in existing or new projects;
 - m. buying and selling shares in other companies, as well as contributing to the capital of other companies;
 - n. approval of new applications and renewal of existing applications for financing the Company or third parties / entities;
 - o. placing encumbrances, mortgages, pledges or guarantees of any other kind on the assets of the Company.
 - p. granting any guarantees or signing any other agreement to ensure the fulfillment of financial or non-financial obligations to third parties, that overcomes 100'000 Euros;
 - q. the sale of the company or its subsidiaries;
 - r. the sale, purchase or exchange of immovable property of the Company.
- 9.2 The Assembly of Partners may take decisions in a valid manner in accordance with the provisions of Law no. 9901, dated 14 March 2008 "On traders and companies", as amended.
- 9.3 In case the General Assembly does not convene with the first call for the absence of one of the Partners, the General Assembly will be convened again within 7 (seven) days with the same agenda.

ARTICLE 10 - ADMINISTRATOR / S

- 10.1 The company is managed by one or more Administrators. In case there is more than one Administrator, the Administrators will act jointly, unless it is differently defined in the act that appointed them in duty. The Administrator (s) will perform his duty until dismissal or resignation or for a period of 5 (five) years, with the possibility of re-election. In case the General Assembly does not make a decision before the end of their term, their mandate will be automatically renewed within one year.
- 10.2 The Administrator/s legally represents the Company. The Administrator has all the rights and competencies of the ordinary administration of the Company, in accordance with Article 95 of Law no. 9901, dated 14 March 2008 "On traders and trade companies", amended and in any case within the limits defined in the act of his appointment and /or in the Statute of the Company.



- 10.3 The administrator/s may appoint representatives by special power of attorney (“ad negotia”) to perform one or several actions, within the limits of the powers given to them by law, statute and /or act of appointment.
- 10.4 The first Administrator of the Company will be appointed *Mr. Malik Nasir Mehmood, Pakistani citizen, born on 21.12.1977, born in Rawaldi, Pakistan adult and with full legal capacity to act, holder of the passport no. BY0150224.*

ARTICLE 13 – PROFITS

- 13.1 The net profits resulting from the annual financial statements are distributed to the Partners in proportion to their corresponding shares in the capital of the Company.
- 13.2 The Assembly may also decide to keep certain amounts as reserves, or to postpone the distribution of profits, in whole or in part, for the following fiscal year (s).

CHAPTER V DISTRIBUTION AND LIQUIDATION OF THE SOCIETY

ARTICLE 14 - DISTRIBUTION

- 14.1 The company is dissolved at the end of its term provided in the Statute or even before this deadline, in cases provided by law or by decision of the General Assembly, by the majority provided for the amendment of the Statute of the Company.
- 14.2 The company is not dissolved in case of disability, death or bankruptcy of the partners.


ARTICLE 15 - LIQUIDATION

- 15.1 In case of distribution, the Company will go through the liquidation procedure.
- 15.2 To administer this procedure, the General Assembly shall appoint one or more liquidators, who shall submit the final report on the liabilities and assets of the Company, on the liquidation operations and the time required to complete the liquidation.
- 15.3 At the end of the liquidation procedure, the General Assembly will take a decision regarding the final financial balance sheet, on the validity of the work performed by the liquidator and on the completion of the liquidation procedure.
- 15.4 After the payment of the creditors / s and the withdrawal of the credits, the liquidator / s will distribute the final liquidation income to the partners, in proportion to the quotas that they respectively have in the capital of the Company.

CHAPTER VI FINAL PROVISIONS

ARTICLE 16 - SETTLEMENT OF DISPUTES

- 16.1 All disputes arising out of or in connection with the interpretation or application of these provisions of this Statute, between the partners or between one or more partners and the



Company, shall be settled by agreement between the parties. In the event that an amicable settlement is not reached, the parties may apply to the Tirana Judicial District Court.

ARTICLE 17 - LEGAL PROVISIONS IN FORCE

17.1 For everything that is not foreseen in this Statute, the legal provisions in force are applied.

17.2 The administrator of the company is authorized to register the company in the Commercial Register, at the National Business Center.

**APPROVED BY:
FOUNDING PARTNERS**

Sikandar ABBAS

Sheikh Muhammad ABDULLAH

SIKANDAR ABBAS

Abdullah.

Sikandar Abbas

Sheikh Muhammad Abdullah